

# Më dhuro një tregim Family Literacy



Shqip / Albanisch

Një projekt për nxitjen e leximit  
për familjet me prejardhje emigruese



Ju si prindër jeni ekspert për zhvillimin gjuhësor dhe për mbështetjen gjuhësore të fëmijëve tuaj. Këtu ju mund të gjeni sugjerime, se si ju mund ta zgjoni tek fëmija juaj dëshirën për gjuhën dhe leximin.



**SIKJM**  
Schweizerisches Institut  
für Kinder- und Jugendmedien

**Të eksplorosh shkrimin së bashku**

Shenjat e shkrimit dhe simbolet e mahnitin fëmijën tuaj. Me ndihmën tuaj ai mund të zbulojë sekretet e shkrimit në rrugën e duhur. Letra dhe lapsat e ftojnë atë për eksperimentim.



### Shkuarja në bibliotekë

Librat mund të bëhen shokë të ngushtë.

Në bibliotekë ju së bashku me fëmijën tuaj mund të huazoni libra për në shtëpi.



### Të përkrahurit e shumë gjuhëve

Fëmija juaj mund të mësojë njëkohësisht mirë dy apo tre gjuhë. Këtu i ndihmojnë atij rregulla të qarta, se kur cila gjuhë duhet folur.



### Krijim kontaktesh

Mos u shqetesoni: në kontakt me fëmijët e tjerë dhe të rriturit, fëmija juaj e mëson shpejt gjermanishten.  
Mundësoni ju atij kontakte te atilla si p.sh.: në grupe loje (Spielgruppe) ose në një çerdhe.



### Të folurit në gjuhën amëtare

Nëse ju flisni me fëmijën tuaj në atë gjuhë që ju e zotëroni më mirë, i jepni kështu atij një bazë të sigurtë për mësimin e gjuhëve të tjera.



### Nxitja për lexim: familja luan një rol vendimtar

Përvojat e larmishme në të shkruar si dhe një trajnim i mirë i gjuhës mëmë është baza më e mirë për mësimin e gjuhës gjermane dhe mësimin e leximit në shkollë.

Projekti *Më dhuro një tregim - Family Literacy* i Institutit Zvicerjan për Mediat Fëminore dhe Rinore SIKJM mbështet prindërit për ti nxitur fëmijët e tyre në gjuhë dhe lexim, si dhe inkurajon këto familje me prejardhje emigruese që të ruajnë gjuhën e tyre amëtare.

### Dëgjoni dhe jepni përgjigje

Fëmija juaj e zhvillon gjuhën e tij nëpërmjet bisedës me ju. Nëse ju flisni me të për vëzhgimet e tij, ai e zgjeron fjalorin e tij dhe krijon dëshirë për zbulimin e gjërave të reja.



### Animime për prindër dhe fëmijë prej 2 deri 5 vjeç

Prindërit dhe fëmijët takohen rregullisht së bashku në një orar të caktuar për të dëgjuar tregime në gjuhën e tyre amëtare.

Animuesja ju fton për këtë, që të tregoni tregime, të luani me këngë dhe vargje poezish, të shikoni libra me figura dhe shumë e shumë gjëra të tjera. Animimet janë për familjet pjesmarrëse Falas. Ato zhvillohen në bibliotekë, në qendrat e lagjeve dhe në kopshtet e fëmijëve. Vizitat shtëpiake mundësojnë krijimin e kontakteve personale.

### Kënaqësia e përbashkët për gjuhën

Me gjuhën mund të luhet më së miri. Vjershat, këngët dhe lojërat me lëvizje bëjnë që fëmija juaj të përjetojë se sa zbavitëse mund të jetë gjuha.



### Arsimim të mëtejshëm për ndërmjetësuesit ndërkulturorë

Animatorët e projektit *Më dhuro një tregim - Family Literacy* janë ndërmjetësuesit ndërkulturorë dhe mësuesit e grupeve të lojës (Spielgruppe). Ata arsimohen më tej nga SIKJM dhe shoqërohen profesionalisht.



### **Të tregosh tregime dhe të shikosh figura**

Tregimet dhe figurat i hapin fëmijës tuaj botë të reja.  
Ai mund ti eksploroj ato së bashku me ju dhe të njohë shumë terma të reja.



### **Gjuhë të ndryshme**

Animimet gjuhësore zhvillohen sipas Prefekturave në gjuhët në vijim: në shqip, arabisht, gjermanisht, frengjisht, në gjuhën kurde, portugalisht, në gjuhën boshnjake/kroate/serbe, spanisht, në gjuhën tamile dhe turke. Sipas nevojave mund të shtohen edhe gjuhë të tjera.

**Bibliotekat ndërkulturore**

Bibliotekat ndërkulturore në Zvicër ofrojnë libra në shumë gjuhë të ndryshme. Ata janë të organizuara në organizatën Interbiblio. [www.interbiblio.ch](http://www.interbiblio.ch)

**Bibliomedia Zvicër**

Bibliomedia Zvicër mund të huazohen libra në njëmbëdhjetë gjuhë të ndryshme nga bibliotekat e qytetit, nga bibliotekat e komunave, nga mësuesit dhe nga bibliotekat e shkollave. [www.bibliomedia.ch](http://www.bibliomedia.ch)

**Instituti Zviceran për Mediat Fëminore dhe Rinore SIKJM**

SIKJM-ja me mbështetjen e komisionit të mëparshëm për të huajt EKA, të qendrave integruese të kantoneve të ndryshme, si dhe të fondacionit AVINA ka zhvilluar projektin *Më dhuro një tregim - Family Literacy*. Në 2008-tën projekti u vlerësua me çmimin Alpha të komisionit zviceran të UNESCO-s ndaj luftës kundër dobësive të theksuara në lexim dhe shkrim të të rriturve. SIKJM-ja angazhohet tashmë për zhvillimin e mëtejshëm dhe zgjerimin specifik të projektit *Më dhuro një tregim - Family Literacy*.

Nxitja për lexim, kërkimi shkencor dhe dokumentacionet në fushën e letërsisë së fëmijëve dhe të rinjve janë detyrat kryesore të SIKJM-së, e cili ka degët edhe në Romandë dhe në Tessin. Përkrahët gjithashtu nga zyra federale e kulturës, nga sekretariati shtetëror për arsim dhe shkencë si dhe nga Kantoni dhe qyteti i Zyrihut.

**Schweizerisches Institut für Kinder- und Jugendmedien SIKJM**

Zeltweg 11, 8032 Zürich  
Tel. 043 268 39 00  
[info@sikjm.ch](mailto:info@sikjm.ch)  
[www.sikjm.ch](http://www.sikjm.ch)



**SIKJM**  
Schweizerisches Institut  
für Kinder- und Jugendmedien